

Data 24.07.2026

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE - Mbi kufirin e lartë monetar -
Prokurim me mjete elektronike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim rruga Kashar - Nyja Vaqarr Faza III”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime
ndërtimi për autostrada, rrugë 45233100-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,549,478,677.74 (një miliard e pesëqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e katër)
Lekë, pa TVSH;

Në Euro: 16,541,888.30 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë pikë tridhjetë) **Euro pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 (Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026).

Bazuar në Nenin 42, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar) “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte risqe të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në një gazetë zyrtare të Bashkimit European.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë (datë **23.07.2026**, ora **12:22:22**);
1 Lek = 93.67 Euro

➤ Në DST është përcaktuar:

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo



Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**punë të ngjashme**):
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor:

Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Nenit 90, pikat 5 dhe 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se për aspektet kritike të kontratës nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për këtë procedurë prokurimi, si aspekte kritike janë konsideruar:

- Përvoja e mëparshme e ngjashme, sipas pikës 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit;
- Licenca profesionale për realizimin e punimeve objekt kontrate, sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Argumentimi teknik:

Objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore rrugore me vlerë të konsiderueshme financiare, kompleksitet teknik dhe rëndësi të veçantë publike. Për realizimin me sukses të kontratës është e nevojshme që operatori ekonomik, i cili do të marrë përsipër ekzekutimin e drejtpërdrejtë të punimeve dhe do të mbajë përgjegjësinë kontraktore ndaj Autoritetit Kontraktor, të disponojë vetë eksperiencën e nevojshme profesionale dhe licencat përkatëse të kërkuara për realizimin e punimeve.

Përvoja e ngjashme përbën një tregues të drejtpërdrejtë të aftësisë teknike, organizative dhe profesionale të operatorit ekonomik për të planifikuar, administruar dhe realizuar kontrata me natyrë, përmasa dhe kompleksitet të krahasueshëm me objektin që prokurohet. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo përvojë duhet të zotërohet nga vetë operatori ekonomik ose nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojnë kontratën, dhe jo nga subjekte të treta që nuk do të marrin pjesë në ekzekutimin e drejtpërdrejtë të punimeve.

Po kështu, licenca profesionale e shoqërisë përfaqëson aftësinë ligjore dhe profesionale për ushtrimin e veprimtarisë ndërtimore në kategoritë përkatëse të punimeve. Kategoritë dhe klasat e licencës fitohen mbi bazën e eksperiencës së shoqërisë, kapaciteteve financiare, strukturës teknike dhe eksperiencës profesionale të personelit drejtues teknik. Për rrjedhojë, licenca përfaqëson një atribut të vetë operatorit ekonomik dhe nuk mund të konsiderohet si një kapacitet që mund të huazohet ose të zëvendësohet përmes mbështetjes në subjekte të treta.

Lejimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto aspekte kritike do të çenonte qëllimin e verifikimit të aftësive reale të operatorit ekonomik që do të ekzekutojë kontratën dhe do të rriste riskun e mosrealizimit të punimeve sipas standardeve, afateve dhe kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor ka respektuar parimin e konkurrencës së lirë, pasi nuk kufizon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurë në formën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku secili anëtar kontribuon me kapacitetet dhe eksperiencën e tij në realizimin e kontratës.

➤ Në DST është përcaktuar:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 60
Metodologjia □□	pikët 5
Stafi / Organizimi i Kompanisë □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit □□	pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ [kriteri 1, 5 a) dhe 5 b)] e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2, 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [60 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Argumentimi:

Kriteri i çmimit është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.*

Duke qenë se objekti i prokurimit përbën një investim publik me vlerë të konsiderueshme financiare dhe financohet nga Buxheti i Shtetit, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se elementi ekonomik duhet të ketë peshën kryesore në vlerësimin e ofertave. Për këtë arsye, çmimit i është atribuar pesha prej 60 pikësh, duke garantuar respektimin e parimeve të efektivitetit dhe përdorimit me eficiencë të fondeve publike.

Formula e vlerësimit siguron trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, transparencë dhe proporcionalitet në vlerësimin e ofertave, duke favorizuar ofertat me kosto më të ulët pa neglizhuar elementët cilësorë që ndikojnë në realizimin e investimit.

2. Metodologjia [5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

Faktorët favorizues: Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

Pajisje inovative: Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Argumentimi:

Kriteri i metodologjisë është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Për shkak të kompleksitetit teknik të punimeve rrugore dhe afatit të realizimit prej 24 muajsh, mënyra e organizimit dhe zbatimit të punimeve përbën një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në

suksesin e kontratës. Metodologjia e propozuar nga operatori ekonomik mundëson vlerësimin e qasjes teknike që do të ndiqet për realizimin e punimeve, organizimin e burimeve njerëzore dhe teknike, koordinimin e aktiviteteve në kantier, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe respektimin e grafikut të punimeve. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive moderne, makinerive bashkëkohore dhe praktikave inovative të ndërtimit mund të ndikojë pozitivisht në cilësinë e punimeve, sigurinë në kantier dhe optimizimin e afateve të realizimit. Për këtë arsye, metodologjia konsiderohet element cilësor me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kontratës.

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin

Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45, pika 8, të VKM Nr. 285/2021, të ndryshuar*. Objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore me vlerë të konsiderueshme dhe procese të shumta teknike që kërkojnë menaxhim profesional, koordinim të vazhdueshëm dhe mbikëqyrje të specializuar. Formimi akademik, eksperiencia profesionale dhe eksperiencia në projekte të ngjashme të stafit kyç përbëjnë tregues të drejtpërdrejtë të kapacitetit të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën sipas kërkesave teknike dhe afateve të përcaktuara. Në mënyrë të veçantë, eksperiencia në kontrata me natyrë dhe kompleksitet të ngjashëm është një element me vlerë të shtuar, pasi dëshmon aftësinë reale të personelit për të përballuar problematika teknike, organizative dhe logjistike të krahasueshme me ato të kontratës objekt prokurimi. Gjithashtu, organigrami e propozuar dhe mënyra e organizimit të stafit mundësojnë vlerësimin e efektivitetit të strukturës menaxheriale dhe teknike që do të përdoret gjatë zbatimit të kontratës.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

Argumentimi:

Punimet objekt kontrate përfshijnë aktivitete ndërtimore me ndikim të mundshëm në mjedis dhe në komunitetin ku do të zhvillohet investimi.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatorët ekonomikë të paraqesin masa konkrete dhe të verifikueshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale gjatë fazës së ndërtimit.

Ky kriter synon të promovojë përdorimin e materialeve me ndikim më të ulët mjedisor, makinerive me efikasitet më të lartë energjetik, menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, kontrollin e pluhurave dhe zhurmave, si dhe zbatimin e masave parandaluese të parashikuara në dokumentacionin mjedisor të projektit.

Gjithashtu, vlerësohen iniciativat që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të zonës së projektit, veçanërisht nëpërmjet punësimit të banorëve lokalë dhe përfshirjes së tyre në procesin e realizimit të investimit.

Duke qenë se kontrata ka ndikim të drejtpërdrejtë në territor dhe komunitet, ky kriter lidhet ngushtë me realizimin e qëndrueshëm të investimit dhe përmbushjen e objektivave mjedisore e sociale të projektit.

5. Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

a) Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [5 pikë]
Kjo, në mbështetje të *Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit"*.

Pikët për këtë nënkriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{\max k1} / V_{\max k1}$$

$V_{\max k1}$ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Periudha e mirëmbajtjes rutinë në përputhje me periudhën e garancisë [5 pikë]

Pikët për këtë nënkriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{\max k1} / V_{\max k1}$$

$V_{\max k1}$ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

Argumentimi:

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të *Nenit 45 të VKM Nr. 285/2021, të ndryshuar*, si dhe kërkesave të legjislacionit teknik për ndërtimin dhe kolaudimin e punimeve.

Periudha e garancisë përbën një tregues të drejtpërdrejtë të besimit që operatori ekonomik ka mbi cilësinë e punimeve dhe materialeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Ofrimi i një periudhe garancie dhe mirëmbajtjeje më të gjatë krijon garanci shtesë për Autoritetin Kontraktor lidhur me performancën e objektit pas përfundimit të punimeve dhe ul rrezikun e kostove shtesë për riparime ose ndërhyrje korrigjuese.

Për një investim rrugor me një vlerë mbi 1 miliard lekë dhe jetëgjatësi të pritshme shumëvjeçare, garantimi i funksionalitetit dhe cilësisë së veprës edhe pas dorëzimit të saj paraqet interes të veçantë publik.

Për këtë arsye, operatorët ekonomikë që ofrojnë periudha më të gjata garancie dhe mirëmbajtjeje vlerësohen me më shumë pikë, duke nxitur paraqitjen e ofertave me cilësi dhe përgjegjësi më të lartë ndaj investimit publik.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe mirëmbajtjeje rutinë, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP (ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 10 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislationit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve

ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 43, pika 1 dhe 2, gërma “a”, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter synon të verifikojë kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë për të realizuar kontratën objekt prokurimi dhe për të përballuar angazhimet financiare që lidhen me ekzekutimin e punimeve. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin punë publike, realizimi i saj kërkon disponimin e burimeve të mjaftueshme financiare për sigurimin e materialeve të ndërtimit, makinerive dhe pajisjeve, fuqisë punëtore, si dhe përballimin e shpenzimeve operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatorët ekonomikë të provojnë një nivel të përshtatshëm aktiviteti ekonomik dhe stabiliteti financiar, i cili garanton aftësinë për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Vlera e kërkuar e xhiros është përcaktuar në masën 100% të vlerës së fondit limit, nivel i cili është më i ulët se kufiri maksimal i lejuar nga *Neni 43, pika 2, gërma “a”, i VKM Nr. 285/2021*. Ky përcaktim respekton parimin e proporcionalitetit dhe synon të garantojë njëkohësisht pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe përzgjedhjen e operatorëve që disponojnë kapacitetin e nevojshëm financiar për realizimin me sukses të kontratës.

Dokumentacioni i kërkuar për vërtetimin e xhiros vjetore mbështetet në të dhënat financiare dhe tatimore të deklaruara nga operatorët ekonomikë në përputhje me *Ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin Nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar, të cilat përcaktojnë mënyrën e deklarimit dhe raportimit të të dhënave financiare dhe tatimore të subjekteve ekonomike.*

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të parqiten konform parashikimit të *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar*, si dhe *Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar*.

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin punë publike, realizimi i kontratës kërkon një gjendje financiare të qëndrueshme, e cila garanton aftësinë e operatorit ekonomik për të siguruar materialet e nevojshme, makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, fuqinë punëtore, si dhe për të përballuar shpenzimet operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit është vendosur për të provuar një aktivitet ekonomik të qëndrueshëm dhe një gjendje financiare të shëndoshë të operatorit ekonomik, duke minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës dhe duke garantuar vazhdimësinë normale të punimeve deri në përfundimin e tyre.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar*, si dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit** është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri është bërë në zbatim të kërkesave të *Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe të parashikimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar*, për kriteret e veçanta të kualifikimit që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë.

Objekti i prokurimit është një vepër infrastrukturore publike me karakter kompleks, e cila përfshin punime civile të rëndësishme në fushën e ndërtimit të rrugëve, punime tokësore, shtresa rrugore, struktura inxhinierike, punime drenazhimi, sinjalistikë, elemente sigurie rrugore dhe punime të tjera të lidhura me funksionalitetin dhe sigurinë e veprës.

Për shkak të natyrës teknike, volumit të punimeve, rëndësisë së objektit dhe ndikimit të drejtpërdrejtë në sigurinë publike dhe funksionimin e infrastrukturës rrugore, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë se kanë realizuar më parë kontrata të një natyre dhe kompleksiteti të krahasueshëm.

Kriteri i kërkuar synon të garantojë që operatori ekonomik disponon:

- eksperiencë konkrete në realizimin e veprave të ngjashme infrastrukturore;
- kapacitet organizativ dhe teknik për menaxhimin e kontratave me vlerë të konsiderueshme;
- aftësi për përballimin e volumeve të punimeve, afateve kontraktuale dhe kërkesave teknike të zbatimit;
- eksperiencë në koordinimin e proceseve të ndërtimit, kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të sigurisë në kantier.

Kërkesa për një kontratë të vetme në masën **50% të vlerës së kontratës që prokurohet** konsiderohet proporcionale me natyrën e objektit, pasi nuk kërkon që operatori ekonomik të ketë realizuar një kontratë me vlerë të barabartë me objektin që prokurohet, por vetëm të ketë provuar eksperiencë në një vepër të krahasueshme.

Alternativa e dytë, që lejon përmbushjen përmes disa kontratave me vlerë totale deri në **dyfishin e vlerës limit**, krijon mundësi më të gjerë pjesëmarrjeje për operatorët ekonomikë që kanë realizuar disa objekte të ngjashme, duke respektuar njëkohësisht nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar kapacitetet reale teknike dhe profesionale.

Kjo qasje siguron një ekuilibër ndërmjet:

- parimit të nxitjes së konkurrencës;
- trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë;
- proporcionalitetit të kriterëve të kualifikimit;
- interesit publik për përzgjedhjen e një operatori me eksperiencë të provuar.

Përcaktimi i periudhës prej **5 viteve të fundit** është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e veprave infrastrukturore rrugore, të cilat kanë cikël realizimi disa vjeçar dhe kërkojnë eksperiencë të vazhdueshme në zbatimin e punimeve sipas standardeve teknike bashkëkohore.

Kjo periudhë është e mjaftueshme për të evidentuar eksperiencën aktuale dhe kapacitetin real të operatorëve ekonomikë, duke shmangur kërkesat kufizuese për eksperiencë shumë të vjetra që nuk reflektojnë domosdoshmërisht kapacitetet aktuale teknike dhe organizative.

Kërkesa për paraqitjen e:

- kontratës së sipërmarrjes;
- situacionit përfundimtar;
- faturave tatimore të deklaruara;
- aktit të kolaudimit;
- formularit të vlerësimit ose vërtetimit të realizimit me sukses;

është vendosur me qëllim verifikimin e plotë të:

- ekzistencës së kontratës;
- vlerës reale të punimeve të realizuara;
- përfundimit të objektit;
- cilësisë së realizimit;
- përmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

Këto dokumente i japin Autoritetit Kontraktor mundësinë për të verifikuar në mënyrë objektive dhe transparente eksperiencën e deklaruar nga operatori ekonomik.

Parashikimi që kriteri të plotësohet sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim është vendosur për të garantuar që secili anëtar i bashkimit të kontribuojë realisht me kapacitetet e veta profesionale dhe eksperiencën përkatëse në realizimin e kontratës.

Në këtë mënyrë shmanget situata ku një operator ekonomik me pjesëmarrje minimale në bashkim përdor vetëm eksperiencën e një operatori tjetër për të plotësuar kriterin, pa pasur kapacitet proporcional për realizimin e pjesës së kontratës që merr përsipër.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-D	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5-E	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-9-C	Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
5	NP-11-C	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
6	NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
7	NS-1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve
8	NS-6-B	Sinjalistika rrugore jondriçuese
9	NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore
10	NS-18-A	Punime topogjeodezike

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale të zbatimit është përcaktuar në përputhje me:

Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, i cili përcakton se Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë dokumente që provojnë aftësinë profesionale dhe teknike të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit;

VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e ndryshuar.

Kërkesa për licencë profesionale është e domosdoshme për shkak se objekti i prokurimit përbën një vepër infrastrukturore publike komplekse, që përfshin punime rrugore, vepra arti, punime hidraulike, punime mbrojtëse, sinjalistikë, punime elektrike dhe elementë të sigurisë rrugore.

Licenca profesionale garanton që operatori ekonomik ushtron ligjërisht veprimtarinë përkatëse; disponon klasifikimin profesional të nevojshëm për kategoritë e punimeve që do të realizojë; është i autorizuar për realizimin e veprave të kësaj natyre;

ka përgjegjësi profesionale dhe teknike për zbatimin e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-D	Punime gjërmimi në tokë	Punime gjërmimi në trupin e rrugës dhe në vepra arti	101-200 milion	113,692,338.12
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Përfshin gjithë punimet në rrugë.	Mbi 800 milion	1,532,680,116.32
NP-5-E	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime për vepra arti dhe mbikalime	201-400 milion	317,880,466.34 milion

NP-9-C	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	Punime sisteme të drenazhimit	51-100 milion	91,281,658.54
NP-11-C	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Punime elektrike	51-100 milion	61,950,301.84
NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime mbjellje dhe gabiona, etj	0-20 milion	15,326,801.16
NS-1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punime për prishjen e ndërtimeve ekzistuese	0-20 milion	5,962,736.64
NS-6-B	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike vertikale dhe horizontale	21-50 milion	32,599,468.97
NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje guardrail, new jersey, parmakë.	101-200 milion	175,840,546.25
NS-18-A	Punime topogjeodezike	Punime gjeodezike në trupin e rrugës	0-20 milion	15,326,801.16

2.3.2/2 Personelin kryesor **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Strukturist)**
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) Inxhinier Elektrik**
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- 1 (një) Inxhinier Mjedi**
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet**
- 1 (një) Inxhinier Mekanik**

*** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtnesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri bazohet në Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar dëshmi mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, për kriteret e veçanta të kualifikimit; VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e ndryshuar, lidhur me kërkesat për drejtnesit teknikë të shoqërive të ndërtimit.

Objekti i kontratës përbën një vepër infrastrukturore komplekse, ku realizimi me sukses kërkon koordinimin e disa disiplinave inxhinierike.

Personeli i kërkuar është përcaktuar në përputhje me natyrën e punimeve, pasi:

Inxhinieri Ndërtimi - është përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm teknik të punimeve të ndërtimit të trupit të rrugës dhe koordinimin e zbatimit të kontratës.

Inxhinieri Strukturist- është i nevojshëm për realizimin dhe kontrollin teknik të urave; veprave të artit; strukturave mbajtëse; elementëve konstruktivë.

Inxhinieri Hidroteknik - është i domosdoshëm për sistemet e drenazhimit; veprat hidraulike; menaxhimin e ujërave sipërfaqësore.

Inxhinieri Elektrik - kërkohet për instalimet elektrike; ndriçimin rrugor; sistemet elektrike ndihmëse.

Inxhinieri Gjeolog - është i nevojshëm për vlerësimin e kushteve gjeologo-inxhinierike; stabilitetin e terrenit; kontrollin e materialeve dhe shtresave.

Inxhinieri Mjedisi - është i nevojshëm për zbatimin e masave të menaxhimit mjedisor; monitorimin e ndikimeve gjatë punimeve; respektimin e kërkesave të lejes mjedisore.

Inxhinieri Topograf/Gjeodet - është i nevojshëm për piketimin e aksit rrugor; matjet topografike; kontrollin e volumetrive dhe pozicionimit sipas projektit.

Inxhinieri Mekanik është i nevojshëm për menaxhimin teknik të makinerive dhe pajisjeve të rënda të ndërtimit; kontrollin e pajisjeve mekanike të përdorura gjatë zbatimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht **120 (njëqind e njëzet) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Qershor 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Qershor 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin **Qershor 2026**.

Argumentim:

Vendosja e kriterit për disponimin e një numri minimal të punonjësve është përcaktuar në përputhje me *Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit.

Objekti i prokurimit "Ndërtim rruga Kashar – Nyja Vaqarr Faza III" përfaqëson një vepër infrastrukturore me volum të konsiderueshëm punimesh, ku realizimi brenda afateve kontraktuale kërkon organizim të përshtatshëm të burimeve njerëzore dhe kapacitet të mjaftueshëm operacional.

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtoare minimale prej 120 punonjësish është përcaktuar bazuar në volumin e konsiderueshëm të punimeve civile; numrin e madh të proceseve të punës që do të zhvillohen paralelisht; nevojën për ekipe të veçanta për punimet tokësore, shtresat rrugore, strukturat, veprat e artit, drenazhimet, sinjalistikën dhe punimet ndihmëse; respektimin e afateve të zbatimit të kontratës; nevojën për garantimin e vazhdimësisë së punimeve në kantier.

Një numër i tillë punonjësish konsiderohet proporcional me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, pasi nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që operatori ekonomik fitues disponon kapacitetet reale organizative dhe njerëzore për realizimin e objektit.

Përcaktimi i një muaji specifik referimi për numrin e punonjësve synon të verifikojë gjendjen reale të fuqisë punëtore të operatorit ekonomik dhe jo një angazhim formal të krijuar vetëm për qëllime të pjesëmarrjes në procedurë.

Dokumentet e kërkuara, si: vërtetimi nga administrata tatimore ose sigurimet shoqërore; listëpagesat sipas formatit ligjor shërbejnë për të provuar në mënyrë objektive; numrin real të punonjësve; deklarin dhe sigurimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi; ekzistencën e kapacitetit njerëzor të operatorit ekonomik.

Në numrin minimal të punonjësve nuk përfshihen vetëm drejtuesit teknikë të kërkuar sipas pikës 2.3.2/2, por të gjithë punonjësit që operatori ekonomik do të angazhojë për realizimin e kontratës.

Në përcaktimin e këtij kriteri është marrë në konsideratë edhe analiza teknike dhe ekonomike e zërave të punimeve objekt kontrate, e hartuar në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018.

Sipas strukturës së kostos së punimeve të ndërtimit, e cila bazohet në elementët përbërës të kostos, konkretisht: materiale; fuqi punëtore; makineri; transport,

Elementi i fuqisë punëtore përbën një komponent të rëndësishëm të kostos së zbatimit të punimeve, duke zënë rreth 20% të vlerës së kostos së analizuar.

Duke marrë në konsideratë këtë peshë të rëndësishme të fuqisë punëtore në realizimin e objektit, si dhe natyrën komplekse të punimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme kërkesën për një numër minimal prej 120 punonjësish, me qëllim garantimin e kapacitetit të nevojshëm operacional për realizimin në kohë dhe me cilësi të punimeve.

Ky numër është përcaktuar duke analizuar volumin e përgjithshëm të punimeve; shpërndarjen e proceseve të punës në kantier; nevojën për angazhimin paralel të grupeve të ndryshme të punës; afatin e realizimit të kontratës; kërkesat për menaxhimin e sigurisë dhe cilësisë gjatë zbatimit.

Kërkesa për fuqinë minimale punëtore nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që operatori ekonomik disponon kapacitetet reale njerëzore dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (**jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë**), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Strukturist)

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Mjedisi

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

1 (një) Inxhinier Mekanik

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi:

- Vendosja e kërkesës për disponimin e stafit mbështetës teknik është përcaktuar në përputhje me *Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"*, i ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, për kriteret e veçanta të kualifikimit.

Objekti i kontratës është një vepër infrastrukturore me kompleksitet të lartë teknik, ku përveç drejtimit teknik të shoqërisë, kërkohet mbështetje e vazhdueshme inxhinierike gjatë fazës së zbatimit të punimeve.

Ndërsa personeli drejtues teknik i licencës garanton përgjegjësinë profesionale dhe ligjore të shoqërisë së ndërtimit, stafi mbështetës teknik është i nevojshëm për ndjekjen e përditshme të proceseve të punës në kantier; kontrollin teknik të punimeve sipas disiplinave përkatëse; koordinimin ndërmjet ekipeve të ndryshme të zbatimit; verifikimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së punimeve me projektin teknik; përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit teknik të zbatimit.

- Kërkesa për profilet përkatëse inxhinierike lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve:

Inxhinieri Ndërtimi – për mbështetjen e punimeve të përgjithshme civile dhe koordinimin teknik të proceseve të ndërtimit;

Inxhinieri Strukturist – për kontrollin dhe ndjekjen e strukturave, urave dhe veprave të artit;

Inxhinieri Hidroteknik – për sistemet e drenazhimit, veprat ujore dhe menaxhimin e ujërave;

Inxhinieri Elektrik – për instalimet elektrike dhe sistemet ndihmëse të infrastrukturës;

Inxhinieri Gjeolog – për verifikimin e kushteve gjeologjike, materialeve dhe stabilitetit të terrenit;

Inxhinieri Mjedis – për zbatimin e kërkesave të menaxhimit mjedisor gjatë punimeve;

Inxhinieri Topograf/Gjeodet – për kontrollin e vazhdueshëm të piketimit, matjeve dhe volumetrive;

Inxhinieri Mekanik – për administrimin dhe kontrollin teknik të pajisjeve dhe makinerive të përdorura në kantier.

- Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë stafin e propozuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca nr. 8) është vendosur në përputhje me procedurën e vetëdeklarimit në prokurimin publik.

Ky mekanizëm lehtëson procesin e ofertimit; shmang ngarkesën administrative për të gjithë operatorët ekonomikë; i mundëson Autoritetit Kontraktor verifikimin e dokumenteve vetëm për ofertuesin e kualifikuar i pari: garanton kontrollin e dokumentacionit përpara shpalljes së fituesit.

- Kërkesa që stafi i deklaruar sipas pikës 2.3.4 të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera të realizuara ose të shpallura fituese është përcaktuar me qëllim garantimin e disponueshmërisë reale të personelit gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Duke marrë në konsideratë vlerën e konsiderueshme të kontratës; kompleksitetin teknik të punimeve; nevojën për prezencë dhe ndjekje të vazhdueshme në kantier.

Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që personeli i deklaruar nuk është i angazhuar në mënyrë të tillë që të pamundësojë përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Ky kriter nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin që burimet njerëzore të deklaruara janë realisht të disponueshme për realizimin e objektit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë personel të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

a) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë "**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**", të lëshuar nga një organizëm trajnimi ose certifikimi i akredituar, vendas ose i huaj, i njohur sipas legjislacionit në fuqi.

b) 1 (një) punonjës që disponon certifikatën "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**", në përputhje me:

Ligjin Nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar (me Ligjin Nr. 161/2014 dhe Ligjin Nr. 99/2024);

VKM Nr. 108, datë 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë ekspertët dhe specialistët që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë", i ndryshuar; dhe

VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për Miratimin e Rregullores 'Për sigurinë në kantier'", i ndryshuar.

*** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri është bërë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar;

legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili vendos detyrime për punëdhënësit dhe subjektet zbatuese për marrjen e masave parandaluese, organizimin e punës së sigurt dhe garantimin e ndërhyrjes në raste emergjente.

Objekti i prokurimit përfshin punime ndërtimore me shkallë të lartë kompleksiteti dhe ekspozim ndaj rreziqeve profesionale, si: punime në lartësi; përdorim i makinerive të rënda të ndërtimit; punime pranë mjeteve dhe pajisjeve mekanike; punime tokësore dhe strukturore; ndërhyrje në zona aktive pune; rrezik aksidentesh gjatë proceseve të zbatimit.

Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel të trajnuar dhe të kualifikuar për organizimin dhe monitorimin e masave të sigurisë në kantier; identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve profesionale; zbatimin e procedurave të emergjencës; dhënien e ndihmës së parë në rast incidentesh deri në marrjen e shërbimit mjekësor.

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** është vendosur për të garantuar zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ky personel do të jetë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e masave të sigurisë në kantier; kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale; monitorimin e kushteve të punës; evidentimin dhe raportimin e rreziqeve; koordinimin e masave parandaluese gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa **për personel të trajnuar për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave** synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në rastet e aksidenteve në punë; dëmtimeve gjatë proceseve të ndërtimit;

situatave emergjente në kantier.

Kjo kërkesë është veçanërisht e nevojshme për kontrata infrastrukture me volum të konsiderueshëm punimesh dhe numër të lartë punonjësish të angazhuar.

Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë personelin e propozuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca nr. 8) është vendosur në përputhje me mekanizmin e vetëdeklarimit në procedurat e prokurimit publik.

Ky mekanizëm lehtëson procesin e ofertimit; siguron deklarimin paraprak të kapaciteteve profesionale; i mundëson Autoritetit Kontraktor verifikimin e dokumenteve mbështetëse vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës; diplomës; librezës së punës; CV-së është vendosur me qëllim verifikimin e ekzistencës së marrëdhënies profesionale; kualifikimit dhe formimit profesional; eksperiencës së personelit të deklaruar; përmbushjes së kërkesave ligjore për funksionet e sigurisë në punë.

Kërkesa që satfi deklaruar në pikën 2.3.5 të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera është përcaktuar me qëllim garantimin e disponueshmërisë reale të personelit të specializuar të deklaruar nga operatori ekonomik, pasi funksionet që lidhen me **sigurinë dhe shëndetin në punë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave** kërkojnë prezencë dhe angazhim efektiv gjatë zbatimit të punimeve. Duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit, volumin e punimeve, numrin e lartë të punonjësve në kantier dhe nivelin e rrezikut të proceseve të punës, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që personeli i deklaruar për këto funksione të jetë realisht i disponueshëm për monitorimin, zbatimin dhe kontrollin e masave të sigurisë gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës. Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e kapacitetit real teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik fitues, duke shmangur situatat kur i njëjti personel deklarohet në mënyrë fiktive në disa kontrata njëkohësisht dhe nuk mund të ushtrojë funksionet për të cilat është kërkuar.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe **nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.***

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri është përcaktuar në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar;

VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", e ndryshuar, lidhur me kërkesat për drejtuesit teknikë të shoqërive të ndërtimit.

Objekti i prokurimit "Ndërtim rruga Kashar – Nyja Vaqarr Faza III" është një vepër infrastrukturore me rëndësi dhe kompleksitet të lartë teknik, ku kërkohet drejtim profesional, koordinim i vazhdueshëm dhe kontroll teknik i proceseve të zbatimit.

Drejtuasi Teknik i Punimeve ka rol thelbësor në organizimin dhe drejtimin teknik të punimeve; garantimin e zbatimit të projektit sipas dokumentacionit teknik të miratuar; koordinimin e personelit teknik dhe ekipeve të punës; kontrollin e cilësisë së punimeve; komunikimin teknik me Autoritetin Kontraktor, mbikëqyrësin e punimeve dhe palët e tjera të përfshira; garantimin e respektimit të kërkesave teknike, kontraktuale dhe ligjore gjatë realizimit të objektit.

Për këtë arsye, kërkohet që Drejtuesi Teknik të jetë person i identifikueshëm, me kualifikimin përkatës profesional dhe i lidhur me operatorin ekonomik nëpërmjet licencës profesionale.

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i angazhuar gjatë realizimit të punimeve është vendosur me qëllim garantimin e një drejtimi teknik efektiv dhe jo vetëm formal të kontratës.

Duke marrë në konsideratë volumin e punimeve; kompleksitetin e veprave rrugore; nevojën për marrjen e vendimeve teknike në kohë reale; koordinimin e shumë disiplinave inxhinierike është e domosdoshme që personi përgjegjës teknik të jetë realisht i disponueshëm gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentim për mosangazhimin në kontrata të tjera

Kjo kërkesë synon garantimin e disponueshmërisë reale të Drejtuesit Teknik të Punimeve, duke shmangur situatat ku i njëjti drejtues teknik deklarohet njëkohësisht për disa kontrata dhe nuk mund të ushtrojë në mënyrë efektive funksionet e drejtimin dhe kontrollit teknik.

Duke pasur parasysh rëndësinë e objektit dhe përgjegjësinë profesionale të këtij pozicioni, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që personi i deklaruar ka kapacitetin dhe kohën e nevojshme për të ndjekur realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e zbatimit cilësor, të sigurt dhe në përputhje me projektin të punimeve objekt kontrate.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 6</i>
2	<i>Kamionçinë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
3	<i>Kamion me vinç</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Fadromë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
5	<i>Greider</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
7	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
8	<i>Autopompë betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
9	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
10	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Eskavatorë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
12	<i>Eskavatorë me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
13	<i>Rul gomë-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
14	<i>Rul gomë-gomë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
15	<i>Rul hekur-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
16	<i>Makineri vijëzimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
17	<i>Makineri për vendosje guardrail</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
18	<i>Sondë shpimi me diametër Ø 600 mm</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
19	<i>Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
21	<i>Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi:

Vendosja e kriterit për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike është përcaktuar në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, veçanërisht dispozitat që lidhen me kërkesat për kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, lidhur me kriteret e veçanta të kualifikimit dhe dokumentacionin që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për të provuar kapacitetet teknike.

Nëpërmjet këtij kriteri Autoriteti Kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë ose kanë mundësi t'u vihen në dispozicion mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të objektit të kontratës.

Objekti i prokurimit "Ndërtim rruga Kashar – Nyja Vaqarr Faza III" është një vepër infrastrukturore me volum të konsiderueshëm punimesh, e cila përfshin një numër të madh procesesh teknologjike, ndër të cilat punime gërmimi dhe lëvizje masash dheu; punime për formimin e trupit të rrugës; punime shtresash rrugore; prodhim dhe vendosje betoni; prodhim dhe shtrirje asfaltbetoni; punime për vepra arti dhe struktura mbajtëse; punime hidroteknike dhe drenazhimi; punime sinjalistike dhe mbrojtëse rrugore; punime ndihmëse dhe përfundimtare.

Për realizimin e këtyre proceseve në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe afatet kontraktuale, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë kapacitete të mjaftueshme mekanike dhe logjistike.

Përcaktimi i listës dhe numrit minimal të mjeteve është kryer mbi bazën e volumit të punimeve të parashikuara në preventivin e kontratës; analizave teknike të zërave të punimeve; metodologjisë së parashikuar për realizimin e objektit; nevojës për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës; afatit të realizimit të kontratës.

Analizat teknike janë hartuar në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018. Në këto analiza, për çdo proces pune përcaktohen burimet teknike të nevojshme, duke përfshirë fuqinë punëtore; materialet; makineritë; transportin.

Bazuar në këto analiza, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar numrin minimal të makinerive të nevojshme për garantimin e realizimit normal të proceseve të punës dhe shmangien e ndërprerjeve gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për disponimin e fabrikës së betonit; fabrikës së asfaltit; nyjes së inerteve është vendosur për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm me materiale bazë për punimet; kontrollin e cilësisë së materialeve të përdorura; respektimin e parametrave teknikë të projektit; shmangien e varësisë nga burime furnizimi që mund të cenojnë ritmin e punimeve.

Kërkesa që këto impiante të disponojnë lejet përkatëse mjedisore është vendosur për të garantuar që proceset e prodhimit dhe furnizimit realizohen në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- | | |
|-------------------------|--|
| - SSH EN ISO 9001:2015 | Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë |
| - SSH EN ISO 14001:2026 | Sistemet e Menaxhimit Mjedisor |
| - SSH EN ISO 45001:2023 | Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë |

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri është përcaktuar në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me mundësinë e autoritetit kontraktor për të kërkuar dëshmi për kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, lidhur me kërkesat që lidhen me standardet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë.

Për shkak të natyrës së objektit të prokurimit "Ndërtim rruga Kashar – Nyja Vaqarr Faza III", i cili përbën një vepër infrastrukturore me volum të konsiderueshëm dhe kompleksitet teknik, Autoriteti Kontraktor e konsideron të nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë sisteme të standardizuara menaxhimi që garantojnë:

Sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) - kërkohet për të siguruar që operatori ekonomik ka një sistem të organizuar për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së punimeve; menaxhimin e proceseve të zbatimit; evidentimin dhe trajtimin e mospërputhjeve; garantimin e realizimit të punimeve sipas projektit teknik dhe specifikimeve.

Duke qenë se objekti përfshin punime rrugore, struktura, vepra arti dhe punime të ndryshme inxhinierike, kontrolli i cilësisë është një element thelbësor i realizimit të kontratës.

Sistemin e menaxhimit mjedisor (ISO 14001:2026) - kërkohet për shkak të ndikimit potencial mjedisor të punimeve, duke përfshirë gjurmimet dhe transportin e materialeve; përdorimin e makinerive të rënda; prodhimin dhe përdorimin e materialeve ndërtimore; menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit; masat për kontrollin e pluhurave, zhurmave dhe ndotjeve.

Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të ndikimeve mjedisore gjatë zbatimit të kontratës.

Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (ISO 45001:2026) - kërkohet për të garantuar organizimin sistematik të masave të sigurisë në kantier, duke marrë në konsideratë numrin e konsiderueshëm të punonjësve; përdorimin e makinerive të rënda; punimet me rrezik profesional; nevojën për parandalimin e aksidenteve në punë.

Ky standard ndihmon në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve profesionale gjatë gjithë ciklit të zbatimit të kontratës.

Pranimi i certifikatave ekuivalente është përcaktuar me qëllim respektimin e parimit të konkurrencës dhe mosdiskriminimit, duke u dhënë mundësi operatorëve ekonomikë të provojnë disponimin e sistemeve të menaxhimit nëpërmjet standardeve të barasvlershme të njohura.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatat për pjesën e punimeve që do të realizojë lidhet me faktin se secili operator duhet të garantojë standardet e menaxhimit për aktivitetet konkrete që merr përsipër në kontratë.

Kjo siguron që të gjitha komponentët e objektit të realizohen nën një sistem të kontrolluar cilësie, mjedisi dhe sigurie.

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi:

Grafiku i punimeve kërkohet në përputhje me *nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar*, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë aftësinë organizative dhe metodologjinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar.

Paraqitja e grafikut të punimeve është e nevojshme për të evidentuar planifikimin logjik dhe kronologjik të proceseve të punës; koordinimin e aktiviteteve kryesore të zbatimit; organizimin e burimeve njerëzore, makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratës; respektimin e afatit kontraktor dhe të etapave të zbatimit; shmangien e mbivendosjes ose ndërprerjeve të proceseve të punës.

Duke qenë se objekti përfshin punime infrastrukturore me volum të konsiderueshëm dhe procese të shumta që zhvillohen paralelisht (gërmime, shtresa rrugore, vepra arti, drenazhime, punime elektrike, sinjalistikë dhe punime përfundimtare), grafiku i punimeve përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e organizimit teknik të operatorit ekonomik dhe realizueshmërisë së kontratës.

2.4.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin për vitet 2026-2028, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Argumentimi:

Vendosja e këtij kriteri është bërë në përputhje me *Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar*, me qëllim garantimin e ekzekutimit normal të kontratës dhe shmangien e mosmarrëveshjeve gjatë fazës së zbatimit.

Paraqitja e deklaratës kërkohet që operatori ekonomik të konfirmojë se është njohur dhe pranon mënyrën e financimit të kontratës, si dhe angazhohet të realizojë punimet në përputhje me afatin kontraktor dhe ritmin e financimit të parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Objekti i prokurimit financohet nga **Buxheti i Shtetit**, sipas planifikimit buxhetor shumëvjeçar të Autoritetit Kontraktor. Financimi është programuar për vitet **2026-2028**, ndërsa vlera totale e kontratës tejkalon fondet e planifikuara për këtë periudhë, duke u shtrirë në përputhje me programimin buxhetor dhe dispozitat ligjore për angazhimet shumëvjeçare.

Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të deklarojë paraprakisht se pranon mënyrën e financimit dhe nuk do të paraqesë pretendime që lidhen me shpërndarjen e fondeve sipas planifikimit buxhetor, për sa kohë Autoriteti Kontraktor respekton detyrimet kontraktuale dhe legjislacionin në fuqi.

Kjo deklaratë synon të garantojë qartësi kontraktuale ndërmjet palëve, të sigurojë realizimin e pandërprerë të punimeve sipas grafikut të miratuar dhe të shmangë mosmarrëveshje që mund të lindin për shkak të mënyrës së financimit të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me *nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, nenin 4, pika 38/b, si dhe nenin 39, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar*.

Specifikimet teknike janë bazuar në projektin e zbatimit, preventivin, raportet teknike dhe dokumentacionin projektues të objektit, duke përcaktuar kërkesat minimale për cilësinë e punimeve, karakteristikat teknike të materialeve, metodat e zbatimit, kriteret e performancës dhe standardet teknike që duhet të përmbushen gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesat teknike janë hartuar në mënyrë që të garantojnë realizimin e punimeve në përputhje me projektin e miratuar; të sigurojnë cilësinë, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e veprës; të garantojnë sigurinë strukturore dhe funksionale të infrastrukturës; të mundësojnë konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në rastet kur në specifikimet teknike referohen standarde kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare, këto referime do të interpretohen gjithmonë të shoqëruara me shprehjen "**ose ekuivalenti i tij/saj**", në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Specifikimet teknike nuk përmbajnë kërkesa që referojnë marka tregtare, prodhues të veçantë, patente, origjinë apo burime specifike, me përjashtim të rasteve kur një referim i tillë është objektivisht i domosdoshëm për përshkrimin e saktë të objektit të kontratës; në çdo rast, referimi shoqërohet me shprehjen "**ose ekuivalente**", duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.